



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 58, Datë 31.03.2022

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TERFOJA” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 KW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.03.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 411 prot., datë 28.03.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Terfoja” me kapacitet të instaluar 1980 kW”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 14.02.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja” me kapacitet të instaluar 1980 kW për një afat 30 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/3 prot., datë 14.02.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.02.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Shoqëria “HEC TERFOJA” sh.p.k., ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “HEC TERFOJA” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. **Plotësuar**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. **Plotësuar**
 - Dokumentacioni teknik për HEC. Neni 9, pika 4.1.1. **Plotësuar**
 - Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, Neni 9, pika 4.1.2. **Plotësuar**
 - Dokumentacioni teknik dhe grafik. Neni 9, pika 4.1.3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar**
 - Dokumentacioni tekniko-ekonomik. Neni 9, pika 4.1.4, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar**
 - Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5., gërma “a”, “b”, “c”. **Plotësuar**
- Në përfundim të afatit të lejes së shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 23.01.2023), do t’i kërkohej shoqërisë ta depozitojë Lejen nga Baseni Ujor me afat të rinovuar, brenda datës 23.01.2023.
- Në lidhje me VNM-në Paraprake të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), me nr. 2888 prot., datë 09.12.2016, për HEC “Terfoje” me kapacitet të instaluar 1980 kW, vlerësojmë se kjo VNM konsiderohet e vlefshme për këtë aplikim në kuptim të interpretimit të dërguar në ERE nga AKM, me e-mail zyrtar të datës 18.02.2020. Sa i përket kryerjes së punimeve ato janë dokumentuar nga ana e shoqërisë nëpërmjet faturave tatimore të shitjes dhe bilanceve të investitorit që ka kryer punimet e HEC “Terfoje”.
- Kontrata nr. 1173 REP., nr. 510/3 KOL., datë 30.05.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Terfojë” me kapacitet prodhues 1.980 MW, në pellgun ujëmbledhës të përroit të fshatit dhe përroit të madh, degë e lumit Bushtricë, Bashkia Kukës, Qarku Kukës., lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të Miratimit shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., ka një afat 49- vjeçar, por ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tërfoje”; me kapacitet të instaluar 1980 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Shoqëria “HEC TERFOJA” sh.p.k. duhet të depozitojë lejen e përdorimit të burimit ujor me afat të rinovuar, brenda datës 23.01.2023.
3. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushteve, sipas përcaktimeve dhe afateve si më sipër.
4. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare